



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 21.5.1-2014-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË MINISTRISË SË KULTURËS
RINISË DHE SPORTIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014

Prishtinë, qershor 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të **Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit** në konsultim me Ndhimës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinioni i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Bujar Bajraktari, i mbështetur nga, Nora Rashiti (Udhëheqëse Ekipi), Donjetë Dreshaj dhe Ylber Sadiku.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	8
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	9
3 Rekomandimet e vitit paraprak.....	14
4 Qeverisja.....	15
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	38
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak	40


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit për vitin 2014 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Ministrin dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 17/11/2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinionit i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, me përjashtim të çështjeve si në vijim:

Ministria kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve ndërmjet kategorive ekonomike në vlerë totale prej 225,141€ (nga subvencionet dhe transferet janë paguar 183,176€ për mallra dhe shërbime; nga mallrat dhe shërbimet 22,571€ janë paguar për investimet kapitale; dhe nga investimet kapitale 19,394€ janë paguar për mallra dhe shërbime). Përveq kësaj në Pasqyrën e realizimit të buxhetit, buxheti final për donacione ishte mbivlerësuar për 70,103€.

Theksimi i Çështjes

Gjithashtu, ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

Informatat në lidhje me pasuritë fikse janë materialisht të nënvlerësuara dhe të pasakta, ngase investimet në vijim prej 11,522,269€ ishin keqregjistruar si pasuri në përdorim duke shkaktuar zhvlerësimin prej 589,437€, dhe në regjistër nuk janë përfshirë të gjitha pasuritë e Ministrisë;


Ministria kishte transferuar mjete financiare në llogaritë bankare të Institucioneve vartëse në shumë prej 195,503€, për përkrahje të projekteve, edhe pse projektet nuk kishin filluar të implementohen; dhe


Ministria nuk kishte shpallur në PVF projektet e subvencionuara/përkrahura me vlerë totale prej 422,313€, të cilat janë në proces të mbylljes/arsyetimit.


(SNISA 200/1705/1706 Opinion i Kualifikuar me Theksim të Çështjes).

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore drejtuar Ministrit janë:







Përgjigja e Menaxhmentit – Auditimi 2014

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha të gjeturat tona të auditimit dhe janë zotuar se do ti adresojne rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shprehemi:

- nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmimeve, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim efektiv financiar dhe kontroll, si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien efikase të outputeve cilësore operacionale. Kjo, për shembull, mund të jetë një aktivitet monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operacionale. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë raporti më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e auditimit të ndërmjetme ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final.

Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do të raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe teste substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF-ve merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Konkluzioni i përgjithshëm

Cilësia e PVF-ve ishte e dobët, u identifikuan një numër i gabimeve materiale dhe lëshime tjera. Gabime të shumta aritmetikore ishin bërë në shpalosjet e shënimeve financiare. Të gjitha obligimet e tjera të raportimit të jashtëm që nuk kanë lidhje me PVF ishin përmbushur plotësisht, në përjashtim të raportit vjetor të punës/performancës.

2.1 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale, me përjashtim të çështjeve si në vijim:

Ministria kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve ndërmjet kategorive ekonomike në vlerë totale prej 225,141€ (nga subvencionet dhe transferet janë paguar 183,176€ për mallra dhe shërbime; nga mallrat dhe shërbimet 22,571€ janë paguar për investimet kapitale; dhe nga investimet kapitale 19,394€ janë paguar për mallra dhe shërbime. Përveq kësaj në Pasqyrën e realizimit të buxhetit, buxheti final për donacione ishte mbivlerësuar për 70,103€.

Theksimi i Çështjes

Gjithashtu, ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

Informatat në lidhje me pasuritë fikse janë materialisht të nënvlerësuara dhe të pasakta, ngase investimet në vijim prej 11,522,269€ ishin keqregjistruar si pasuri në përdorim duke shkaktuar zhvlerësimin prej 589,437€, dhe në regjistër nuk janë përfshirë te gjitha pasuritë e Ministrisë; dhe

Ministria kishte transferuar mjete financiare në llogaritë bankare të Institucioneve vartëse në shumë prej 195,503€, për përkrahje të projekteve, edhe pse projektet nuk kishin filluar të implementohen; dhe

Ministria nuk kishte shpalosur në PVF, projektet e subvencionuara/përkrahura me vlerë totale prej 422,313€, të cilat janë në proces të mbylljes/arsyetimit.

(SNISA 200/1705/1706 Opinion i Kualifikuar me Theksim të Çështjes).

2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, e datës 17/11/2014, janë identifikuar tri rreziqe domethënëse në PVF dhe atë:

- mungesa nga puna stafit kyq financiar dhe ndikimi në prodhimin e PVF-ve;
- mospërfshirjen e të gjitha pronave të Ministris në regjistrat e pasurisë; si dhe
- transferin e mjeteve tek llogaritë komerciale të Institucioneve vartëse për financimin e projekteve kapitale.

Këto janë rreziqe të anomalive materiale, të cilat mund të rezultojnë në modifikim të opinionit.

Rreziku i identifikuar

Çështja 1 - Ndikimi i mungesës së stafit financiar në cilësinë e PVF-ve - Prioriteti i lartë

Përgjigja dhe gjetjet e auditimit

Gjatë auditimit ne kemi konsideruar kontrollet e Ministrisë lidhur me prodhimin e PVF-ve dhe kemi konstatuar se ato përmbanin një numër të konsiderueshëm të gabimeve disa prej të cilave ishin të rëndësishme materiale. Kjo kryesisht kishte ndodhur për shkak të mungesës së stafit kyq financiar por edhe për shkak se procesi i përgatitjes së tyre nuk ishte rishikuar si duhet nga Menaxhmenti. Gabimet me ndikim më të madh ishin si në vijim:

- Në shënimin 17, buxheti final i donacioneve ishte mbivlerësuar për 70,103 dhe në shënimin 24, buxheti final i mallra dhe shërbimeve ishte nënvlerësuar për 11,911€;
- Tek shpalosjet e Pasqyrës së pranimeve dhe pagesave - në shënimin 9 (për mallra dhe shërbime), mungonte totali i shpenzimeve, dhe kodet ekonomike përmbanin vlera jo të sakta;
- Shpalosjet e detyrimeve dhe të pasurive nuk ishin të sakta, (shih nënkaptullin 4.4.6 *Trajtimi i Borxheve dhe nënkaptullin 4.4.5 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale*);
- Nuk kishte shpalosje të duhur të informatave për projektet e paarsyetuara përgjatë vitit 2014 dhe nga vitet paraparake;
- Tek shënimi 36 nuk ishin dhënë sqarime për lëvizjet buxhetore përgjatë vitit. Poashtu nuk janë paraqitur informata për numrin e punëtoreve; dhe
- Raporti vjetor financiar i BKK-së, megjithëse kishte gabime materiale, nuk ishte marrë parasysh gjatë hartimit të PVF-ve të Ministrisë. Si pasojë kanë mbetur të pashpalosura informatat në lidhje me pasurinë dhe obligimet e papaguara të BKK-së

Rekomandimi 1 Ministri duhet të siguroj që procesi i prodhimit të PVF-ve të përfshin një rishikim të detajuar të draft PVF-ve nga ana e Menaxhmentit para se Pasqyrat të dërgohen në Thesar. Fokusi kryesor duhet të jetë në fushat me rrezik të lartë dhe ku janë identifikuar gabime. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet nëse nuk janë implementuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

Çështja 2 – Mosregjistrimi i të gjitha pronave të Ministrisë – Prioriteti i Lartë

Përgjigja dhe gjetjet e auditimit

Ne i kemi vlerësuar kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për ta dëshmuar plotësinë e të dhënave rreth pasurive në kontekst të identifikimi dhe regjistrimit të tokave, objekteve dhe ndërtesave të cilat janë në pronësi të Ministrisë. Në memon e auditimit të ndërmjetëm, ne i kemi dhënë këshilla Menaxhmentit për veprimet që nevojiten për të siguruar që shifra e pasurive në PVF të jetë e plotë dhe e saktë. Megjithatë, rreziku i identifikuar është materializuar sepse Menaxhmenti nuk ka arritur të dëshmoj plotësinë e pasurive në mungesë të inventarizimit të tyre në fundvit para se PVF të përgatiten.

Rekomandimi 2 Ministri duhet të siguroj që të hartohet një regjistër gjithpërfshirës i pasurive i cili do të paraqes një pasqyrë e plotë dhe të saktë të e pasurive të Ministrisë dhe kjo të reflektohet në PVF-të e vitit 2015.

Çështja 3 – Transferi i mjeteve financiare në llogaritë e Institucioneve vartëse – Prioriteti i lartë

Përgjigja dhe gjetjet e auditimit

Gjatë auditimit të ndërmjetëm ne kemi shqyrtuar kontrollet e Menaxhmentit dhe proceset shoqëruese që janë zbatuar për transferimin e mjeteve financiare në llogaritë komerciale të Institucioneve vartëse si dhe kemi dhënë këshilla për ti përmirësuar ato. Ne kemi audituar një mostër transaksionesh për të gjithë vitin financiar lidhur me rregullsinë e pagesave. Vlera prej 195,503€ është transferuar në llogaritë bankare të Muzeut Kombëtar dhe Institutit Arkeologjik për projekte të cilët ende nuk kanë filluar. Kjo ka ndikuar që rreziku të materializohet, ngase mjetet e pashpenzuara janë klasifikuar si shpenzime, ndërsa realisht janë pasuri e Ministrisë.

Rekomandimi 3 Ministri duhet të shqyrtoj shkaqet që po ndikojnë që transferimi i mjeteve tek institucionet vartëse të përsëritet vit pas viti dhe të identifikoj veprimet që duhet të ndërmerren që kjo të mos përsëritet në të ardhmën.

2.3 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Përshkrimi

MKRS duhet të jetë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013;
- Pajtueshmërinë me kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048;
- Kërkesat e buxhetit;
- Raportet tremujore, përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmujore; dhe
- Kërkesat në lidhje me planifikimin e prokurimit.

Çështjet e ngritura në memon tonë të auditimit të ndërmjetëm, e datës 17/12/2014 në lidhje me kornizën raportuese nuk janë adresuar plotësisht nga Menaxhmenti pasi që një numër i gabimeve kanë ndodhur në PVF. Çështjet e dala lidhur me pajtueshmërinë e PVF-ve janë shtjelluar në nënkapitullin 2.2 *Rreziqet Domethënëse në Pasqyra Vjetore Financiare*.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Ministria nuk ka dorëzuar me kohë planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve tona. Për shkak të nivelit të ulët të implementimit të rekomandimeve është e rëndësishme që Ministria të ndërmarrë veprime më proaktive dhe me një qasje më të detajuar lidhur me përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të të vitit 2014 të MKRS ka rezultuar në 19 rekomandime kryesore. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2014, një rekomandim është adresuar plotësisht; katër janë adresuar pjesërisht, dhe 14 (katërmbëdhjetë) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 4 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

E gjetura Dorëzimi me vonesë i planit të veprimit (tetor 2014), dhe mungesa e veprimeve të menaxhmentit kanë ndikuar që vetëm një rekomandim i vitit të kaluar të zbatohet. Ministria nuk ka zbatuar ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve të AP.

Rreziku Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe, kanë rezultuar në:

- Mos-efikasitet të vazhdueshëm organizativ dhe mungesë të qeverisjes së mirë;
- Procedura jo efektive të prokurimit dhe menaxhim i dobët i projekteve kapitale;
- Menaxhim i dobët i procesit të dhënies dhe arsyetimit të subvencioneve
- Vazhdimin e angazhimit të punonjësve me kontrata për shërbime të veqanta pa procedura të rekrutimit; dhe
- Menaxhim i dobët dhe shpалosje joadekuate të pasurive në PVF.

Rekomandimi 4 Ministri duhet të sigurojë që një plan i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Rekomandimet që nuk implementohen brenda afateve të pritshme kohore duhet të shqyrtohen formalisht nga Ministri dhe të merren veprime proaktive për t'i adresuar arsyet e raportuara për vonesat e implementimit.

4 Qeverisja

Konkluzioni i përgjithshëm

Aspektet kyçe të kornizës së qeverisjes që duhet të adresohen nga Ministria janë si në vazhdim:

- **Vetëvlerësimi** – edhe pse është zbatuar nga MKRS, ka mundur të jetë më vetë-kritike gjatë vetëvlerësimit në mënyrë që të kjo të shërbejë si një pikënisje për të përmirësuar performancën e saj aty ku shihet e nevojshme;
- **Menaxhimi i rrezikut** – MKRS ende nuk ka krijuar procedura formale dhe të dokumentuara të identifikimit dhe menaxhimit të rreziqeve në nivel të organizatës që do të zbusnin ekspozimin ndaj rreziqeve që ndërlidhen me arritjen objektivave;
- **Raportimi i brendshëm dhe kontrolli menaxherial** – ka ngritur perspektivën e raportimit të dobët brenda Ministrisë, departmenteve dhe Institucioneve vartëse;
- **Sistemi i Auditimit të Brendshëm** – ku një plan i auditimit i vlerësuar në bazë të rrezikut është zbatuar plotësisht duke u mbështetur në mënyrë efektive nga Komiteti i Auditimi.

Si të tilla, aranzhimet e përgjithshme të qeverisjes kërkojnë përmirësim. Kontrollat mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të parandalohet që Ministria të ketë humbje financiare, vlerë të dobët për paranë dhe menaxhim jo efektiv. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë realizimi i buxhetit tek investimet kapitale, menaxhimi i subvencioneve për përkrahjen e veprimtarisë dhe aktiviteteteve të Institucioneve vartëse, në përkrahjen financiare të përfituesve, dhe tek menaxhimi i pasurisë.

4.1 Qeverisja e mirë

Përshkrim

Qeverisja ka të bëjë me sistemin me anë të cilit Organizatat janë menaxhuar dhe kontrolluar. Qeverisja efektive kërkon planifikim të fortë, monitorim dhe marrëveshje raportuese të cilat qartë adresojnë rreziqet operationale dhe strategjike me të cilat përballen Organizatat.

MKRS menaxhon edhe 17 Institucione vartëse për të cilat e bën financimin e aktivitetit bazë si dhe përkrahjen e projekteve të ndryshme kulturore, ndërsa nga viti 2013 ka nën menaxhim Bibliotekën Kombëtare të Kosovës (BKK). Për secilin Institucion ndahen mjete për financimin/përkrahjen e projekteve të ndryshme kulturore dhe të trashëgimisë kulturore të cilat jepen në formë të avancit. Të njëjtat figurojnë si avance të hapura deri në kompletimin dhe raportimin e tyre. Kjo shkakton raportim të gabueshëm të tyre në pasqyra financiare.

Çështja 5 - Aranzhimet e përgjithshme të qeverisjes – Prioriteti i lartë

- E gjetura** Raportet e rregullta të drejtorëve nuk kanë qënë formalisht të shqyrtuara nga Sekretari i Përgjithshëm dhe menaxhmenti i lartë. Për këtë arsye nuk jemi mbështetur në kontrollet e niveleve të larta të Menaxhmentit gjatë auditimit;
- Institucionet vartëse çdo tre muaj duhet të raportojnë në Ministri lidhur me ecurinë financiare të aktiviteteve të tyre. Jo çdo herë afatet ishin respektuar pasi që gjatë 2014 pesë¹ Institucione kishin raportuar pas afatit dhe Ministria nuk kishte ndërmarrë asnjë hap konkret në këtë drejtim;
- Në raportet financiare vjetore të pesë Institucioneve Vartëse, nuk ishte bërë harmonizimi i shënimeve me llogarinë bankare²; dhe
- Për projektet që i financon Ministria, Institucionet vartëse duhet të mbajnë evidenca dhe ti arsyetojnë shpenzimet e bëra. Një gjë e tillë, nuk është bërë në Muzeun e Kosovës, pasi që ecuria e projekteve dhe regjistri i shpenzimeve të bëra nuk mirëmbahej;
- Çështjet e trajtuara më lartë reflektojnë mungesë të njohjës së rëndësisë së mekanizmave të raportimit efektiv.
- Rreziku** Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë së dobët e reduktojnë efektivitetin e menaxhimit, kanë ndikim negativ në kontrollin buxhetor dhe shfaqin mundësi për humbje financiare. Kjo rezulton në dobësi në procesin buxhetor dhe zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë.
- Rekomandimi 5** Ministri në bashkëpunim me Udhëheqësit e Institucioneve vartëse duhet të bëjnë një rishikim të çështjeve të identifikuara, për të gjetur shkaqet e ndodhjes dhe për të përcaktuar masat e nevojshme për të futur në zbatim një raportim financiar të rregullt dhe cilësor. Rolet dhe përgjegjësitë e Ministrisë dhe të institucioneve në këtë proces duhet të qartësohen.

¹Baleti i Kosovës, Qendra Kinematografike e Kosovës, Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve (IMM) Gjakovë, Qendra Rajonale e Trashigimisë Kulturore (QRTK) Prizren dhe QRTK Mitrovicë.

² Në formatin ekzistues të raporteve financiare të Institucioneve Vartëse, duhet të ofrohen të dhëna financiare lidhur me hyrjet dhe daljet e parasë, të cilat duhet të barazohen me gjendjen bankare.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i Buxhetit

Përshkrimi

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për MKRS, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ³	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Burimet e Fondeve:	20,115,174	19,655,836	16,780,838	15,515,293	16,886,430
Granti i Qeverisë -Buxheti	20,072,274	19,126,663	16,378,177	14,356,009	16,297,680
Te hyrat e bartura nga viti paraprak ⁴	-	18,665	9,16	1,856	3,279
Te hyrat vetanake ⁵	42,900	42,900	4,869	12,179	18,706
Donacionet e jashtme	-	467,607	388,375	1,145,248	566,765

Buxheti fillestar ishte përshtatur gjatë vitit. Në njërin anë, 214,099€ ishin shkurtuar në emër të kursimeve buxhetore, dhe 1,086,970€ të tjera ishin tërhequr nga MF pasi kishin mbetur të pashpenzuara. Në anën tjetër, ishin shtuar donacionet në shumë prej 467,607€ dhe të hyrat prej 18,665€. Si rezultat i ndryshimeve, buxheti final ishte për 459,338€ më i ulët se buxheti fillestar.

Në vitin 2014, MKRS ka përdorur rreth 85% të buxhet final ose 16,780,838€, me një përmirësim krahasuar me vitin 2013 (78%) të buxhetit. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - realizimi ndaj buxhetit (në €).

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	20,115,174	19,655,836	16,780,838	15,515,293	16,886,430
Pagat dhe Mëditjet	2,800,112	3,186,734	3,156,936	2,456,053	2,421,071
Mallrat dhe Shërbimet	1,074,272	1,349,601	1,235,932	1,236,386	1,102,369
Shërbimet komunale	381,557	299,199	275,099	178,029	187,339
Subvencionet dhe Transferet	5,356,550	5,854,668	5,803,017	5,869,321	4,760,692
Investimet Kapitale	10,502,683	8,965,713	6,309,852	5,775,501	8,414,957

³ Buxheti Final - Buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave.

⁴ Të hyrat vetanake të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁵ Të hyrat e planifikuara dhe të mbledhura në vitin aktual që është përdorur nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti për investime kapitale kishte realizim të ulët gjatë vitit. Për këtë arsye thesari ju kishte shkurtuar buxhetin për 1,086,970€. Pavarësisht kësaj, Ministria kishte realizuar vetëm 70% të buxhetit final. Prej tyre 1,081,294€ apo 12% janë shfrytëzuar për pagesën e faturave të vitit 2013. Ndër shkaqet kryesore për këtë nënshpenzim ishin mos implementimi i disa projekteve të planifikuara dhe vonesat në procedurat e prokurimit.
- Ekzekutimi i buxhetit për mallra dhe shërbime ishte 91%. Fillimisht me vendim të Qeverisë ishte zvogëluar buxheti te kjo kategori për 15%, derisa gjatë vitit janë shtuar mjete nga donacionet. Megjithatë kjo kategori e shpenzimeve nuk ishte menaxhuar mirë, pasi që në fund të vitit kishte një suficit prej 113,669€, ndërsa obligimet e papaguara nga kjo kategori ishin 106,991€;
- Rritja e buxhetit për paga dhe mëditje ishte si rezultat i vendimit të Qeverisë për rritje për 25% të pagave nga prilli 2014, alokimit të fondit për kuadro, dhe alokimit të fondeve të donatorëve. Realizimi i buxhetit ishte mbi 99%; dhe
- Ekzekutimi i buxhetit për subvencione dhe transfereve ishte 99%. Një pjesë e konsiderueshme e shpenzimeve nga kjo kategori ekonomike është keqklasifikuar, si pasojë e mos planifikimit të saktë të buxhetit dhe mungesës së mjeteve në kategori tjera.

Rekomandimet

Çështja 6 - Planifikimi dhe Realizimi i buxhetit - Prioriteti i lartë

- E gjetura** Planifikimi i buxhetit për investime kapitale nuk ishte bërë në bazë të vlerësimeve reale ose trendit nga vitet paraprake, gjë që ka ndikuar në nivelin e ulët të realizimit (70%). Këtë e dëshmon suficiti prej 3,700,000€. Trendi më i madh i shpenzimit vërehet në dy mujorin e fundit të vitit, përderisa 1,081,294€ janë paguar për faturat e papaguara nga viti 2013. Këto kanë ndodhur ngase mungonte një politikë e duhur për ekzekutimin e pagesave, dhe vonesave dhe ndërprerjeve të punimeve nga operatorët ekonomik.
- Rreziku** Planifikimi jo i mirë dhe realizimi i ulët i buxhetit tek investimet kapitale do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm.
- Rekomandimi 6** Ministri duhet të siguroj që përgatitja e buxhetit është paraprirë nga një proces i vlerësimit që reflekton të gjitha informatat relevante, përfshirë edhe realizimet e viteve të kaluara dhe ndryshimet e pritura në vitin e ardhshëm. Poashtu, Ministri duhet të monitorojë performancën buxhetore në baza mujore në mënyrë që të identifikohen dhe adresohen barrierat që shkaktojnë vështirësi në realizimin e buxhetit.

4.3 Të hyrat

Përshkrimi

MKRS realizon të hyra nga participimet në aktivitetet kulturore, nga Departmenti i Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore si dhe Bibliotekës Kombëtare. Për vitin 2014 sipas shënimeve të Thesarit Ministria kishte grumbulluar shumën prej 34,513€, ndërsa fonde nga donacionet ndërkombëtare ishin pranuar në vlerë prej 537,770€.

Rekomandimet

Çështja 7 - Mungesë e raportimit për të hyrat e realizuara - Prioriteti i mesëm

E gjetura Ansambli “Shota” (të hyrat 9,368€) dhe IMM Prizreni (të hyrat prej 10,368€) nuk i kishin raportuar me kohë. Derisa Ansambli i kishte shpenzuar të hyrat jashtë llogarisë së Thesarit;

Teatri Kombëtar ka vazhduar edhe këtë vit të ofroj hapësirën e byfesë me qira, duke mos pasur marrëveshje kontraktuese.

Këto çështje kanë ndodhur sepse rregulloret relevenate nuk janë respektuar dhe ka munguar bashkëpunimi i mirëfilltë ndërmjet Ministrisë dhe Institucioneve vartëse.

Rreziku Të vepruarit në kundërshtim me rregullat qeveritare në lidhje me të hyrat dhe shpenzimet shkakton menaxhim joefektiv të të hyrave dhe njëherit ndikon në menaxhimin e të dobët të aktivitetëve në kuadër të Ministrisë dhe mund të dërgoj në shfrytëzimin joadekuat të burimeve financiare.

Rekomandimi 7 Ministri duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi të përshtatshëm, që mbështet mbledhjen, evidentimin, barazimin dhe raportimin e të hyrave. Dhënia në shfrytëzim e hapësirave të Institucioneve vartëse duhet të bëhet nëpërmjet një procesi transparent tenderues.

4.4 Shpenzimet

4.4.1 Prokurimi

Përshkrimi

Rregullat e prokurimit kanë për qëllim të sigurojnë që fondet publike të arrijnë vlerën për para përmes aplikimit të një sistemi transparent dhe efikas. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në prokurim publik. Kjo përfshinë kërkesat për të zvogëluar rreziqet në respektimin e vonesave në përfundimin e punimeve, shmangies së konfliktit të interesit dhe ofertave jo të plota dhe arritjen e vlerës për para.

MKRS bazuar në planin vjetor të prokurimit kishte zhvilluar procedura të prokurimit dhe kishte nënshkruar kontrata me vlerë të përgjithshme rreth 2,374,026€ dhe me vlerë minimale 40,295€.

Ne kemi analizuar ndërlidhjen e projekteve kapitale me Programin për Investime Kapitale (PIP) dhe me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve. Poashtu kemi testuar edhe rregullsinë e procedurave të prokurimit. Një numër i konsiderueshëm i projekteve kapitale të parapara në Kornizën afatmesme të shpenzimeve të realizohen gjatë vitit 2014 nuk ishin realizuar fare, ndërsa projektet e kontraktuara viteve të mëparshme kishin progres të ulët si pasojë e vonesave në realizimin e punimeve dhe planifikimeve jo të sakta të pozicioneve në paramasë.

Rekomandimet

Çështja 8 – Dobësi sistematike në prokurim – Prioritet i lartë

E gjetura Nga shqyrtimi i 16 kontratave kemi identifikuar çështjet e mëposhtme:

Janë kryer pagesa për punë që nuk janë kryer për projektet në vijim:

- Për ndërtimin e Palestrës Sportive në Istog”, vlera e paguar në total ishte 823,507€. Ishte paguar diku rreth 70% e kontratës derisa ishin përfunduar më pak se 50% të punëve të kontraktuara. (Pas vërejtjeve tona dinamika e punimeve ka filluar të përmirësohet);
- Për “Palestrën Sportive në Rahovec”, vlera e paguar për punë të pakryera ishte 143,402€; dhe
- Për “Palestrën Sportive në Skenderaj”, vlera e paguar për punë të pakryera ishte 33,420€.

Kontratat ishin lidhur në 2009 dhe sipas planit të rishikuar dinamik, punimet do të duhej të përfundonin deri në vitin 2014. Deri në qershor 2015 ato nuk ishin kryer ende. Projektet nuk kanë qenë të sakta ngase gjatë punimeve është shfaqur nevoja për sasi më të mëdha të materialeve sesa janë të parapara me paramasë dhe të kontraktuara.

Rastet e mësipërme rezultojnë në pagesa të parregullta, krijojnë mundësinë për menaxhim jo të mirë të financave si dhe eventualisht mund të ndikojnë në mos përfundimin e duhur të projekteve.

Kryerja e pagesave në mungesë të raportit të pranimit - Për "Restaurimin e shtëpisë së Familjes Dukagjini në Prizren" janë paguar 3,377€ në mungesë të raportit nga Komisioni për pranimin teknik të punëve. Raporti i pranimit kishte munguar edhe në dy raste tjera - për furnizimim me klima elektronike si dhe ngjyrosja e sallës së Galerisë Qafa. Procesimi i pagesave në mungesë të raportit për punën e kryer/mallin e dorëzuar nuk jep siguri nëse ajo që është paguar është pranuar në sasinë dhe cilësinë e duhur.

Planifikimi joadekuat i nevojave për blerje - Planifikimi joefektiv ka bërë që të dalin nevojat për furnizime të përsëritura përgjatë vitit. Furnizimet kishin të bënin me artikuj me vlerë të vogël dhe ato ishin siguruar përmes kuotimit të çmimeve. Mirëpo, në rastet kur furnizimet ishin të natyrës së ngjashme, blerja e përbashkët (e grumbulluar) e tyre do të ofronte mundësinë për zhvillimin e procedurave më konkurruese dhe eventualisht arritjen e vlerës më të mirë për parane e shpenzuar.

Kërkesat e njësisve kërkuese nuk ishin të qarta - Në 11 mostrat e testuara në BKK, me vlerë 56,353€, kërkesat për blerje nuk ishin të qarta dhe nuk përmbanin informata lidhur me specifikat e punëve/shërbimeve të kërkuara. Për më tepër, tek dy kontrata⁶ kërkesat për inicim të procedurave të prokurimit përmbanin edhe çmimin e saktë të kontratës. Në dy raste tjera, aprovimi i kërkesave për inicim të procedurave ishte bërë pas pranimit të mallrave;

Juria Profesionale për vlerësimin e projektit të Pallatit Olimpik nuk ishte përzgjedhur si duhet - Sipas rregullave të prokurimit, juria duhet të jetë e pavarur, ndërsa ne kemi vërejtur se me këtë rast shumica nga 11 anëtarët e përzgjedhur të jurisë ishin punonjës të MKRS-së. Për më tepër, pagesa e tyre prej 5,750€ është kryer nga buxheti për investime kapitale;

⁶ Kontrata "Furnizimi dhe montimi i dritareve pvc në BKK" dhe "Furnizimi dhe montimi i dyerve automatike në hyrjen zyrtare të BKK-së".

Keqklasifikimi i shpezimeve si dhe pagesa nga kodet joadekuate të projekteve - Në shumë raste, blerjet kapitale ishin klasifikuar respektivisht ishin paguar nga buxheti për mallra dhe shërbime dhe anasjelltas. Vlera prej 22,571€ është paguar nga mallra dhe shërbimet për investime kapitale, dhe 19,394€ nga investimet kapitale për mallra dhe shërbime. Kjo ishte bërë për shkak të mungesës së buxhetit për projektet përkatëse. Për arsye të njëjta, renovimi i Stadiumeve të futbollit në vlerë prej 28,914€ ishte financuar nga buxheti i ndarë për renovimin e palestrave. Këto raste ndikojnë në cilësinë e regjistrimit dhe të raportimit financiar si dhe në mos realizimin e projekteve për të cilat ishte ndarë buxheti në fillim.

Kërkesa dhe furnizimi për shërbime nuk kishin konsistencë - Në katër⁷ kontrata në vlerë prej 22,168€ specifikat teknike nuk e reflektonin furnizimin e bërë, ngase janë furnizuar artikuj jashtë kontratës. Është bërë furnizim më shumë në krahasim me kontratën në vlerë prej 6,769€;

Sigurimi i ekzekutimit kishte skaduar - afati i sigurimit të ekzekutimit për dy kontrata me vlerë të përbashkët 1,922,626€ kishte skaduar.

Rreziku

Të gjeturat e mësipërme rrisin rrezikun që të ndodhin shpenzime jo racionale, procedura jo konkurruese dhe jo transparente si dhe humbjen e vlerës së parasë së shpenzuar.

Rekomandimi 8

Ministri duhet të inicoj urgjentisht analiza për arsyet prapa dobësive sistematike të identifikuara. Analizat duhet të identifikojnë ndërmarrjen e masave të nevojshme dhe duhet të finalizohen deri në tetor 2015.

⁷ Kontrata "Renovimi i Koridoreve të shtëpisë së sportit dhe vendosja e dyerve të hyrjës kryesore", "Furnizimi me helmeta dhe fasciklla" "Furnizimi me paisje sportive" dhe Kontrata nga Biblioteka Kombëtare "Furnizimi dhe montimi i dritareve në BKK".

Çështja 9 – Dobësitë jo-sistematike të prokurimit - Prioritet i lartë

E gjetura Nga rishikimi i 16 kontratave, ne kemi identifikuar se disa kontrolle nuk janë zbatuar me konsistencë dhe kanë rezultuar me:

Lidhja e kontratave pa procedura të prokurimit - Për kontraktimin e shërbimeve “Intervenimet emergjente në objektet e trashëgimisë kulturore” Ministria nuk kishte hapur tender mirëpo ketë shërbim e kishte marrë në bazë të një Marrëveshje të Mirëkuptimit (MiM) të nënshkruar me Culture Heritage Without Borders (CHWB). Pagesa gjatë vitit për këto shërbime ishin 150,000€;

Punimet ishin bërë para procedurave të prokurimit - Tek një kontratë⁸ prej 3,600€, punimet kishin filluar para se të zhvillohen procedurat e prokurimit.

Këto të gjetura kanë ndodhur ngase monitorimet e duhura kishin munguar dhe se nuk ishin zbatuar rregullat e prokurimit.

Rreziku Lidhja e kontratave pa procedurë të prokurimit dhe zhvillimi i punimeve para aktiviteteve të prokurimit rrezikon cilësinë e punimeve.

Rekomandimi 9 Ministri duhet të shqyrtojë pse kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë në rastet e mësipërme dhe të ushtrojë më shumë kontrolle për të siguruar që situata të tilla nuk do të përsëriten.

4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrim

Shpenzimet të cilat nuk i nënshtrohen procedurave të prokurimit kanë të bëjnë me shpenzimet komunale, shpenzimet e udhëtimit dhe përfaqësimit etj.

Çështja 10 – Aprovim jo i duhur për kompensimet për punë shtesë - Prioritet i mesëm

E gjetura MKRS kompenzon stafin e saj për mbikqyrje të projekteve kapitale. Me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm ishte bërë kompenzimi 2,987€ për punën shtesë (për mbikqyrjen/menaxhimin e projekteve kapitale) ndaj zyrtarëve të Ministrisë. Në dosje nuk ishin të bashkangjitura raportet përcjellëse, ndërsa kalkulimi i shumës për kompenzim është bazuar në rregulloren për punë jashtë orarit.

⁸ Kontrata “Vendosja e shtyllave statike në tribunat lindore në Stadiumin Olimpik Adem Jashari”.

- Rreziku** Një pagesë e pambështetur me dokumentet e nevojshme/raportet e punës rrezikon transparencën dhe shfrytëzimin jo efektiv të parasë publike.
- Rekomandimi 10** Ministri duhet të sigurojë që pagesat për punë shtesë të realizohen vetëm pas kërkesës për pagesë dhe të kompletuara me dokumentet e nevojshme.

4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar qeveritar. Kontrollat që operojnë në nivel të Ministrisë kanë të bëjnë me: autorizimin e listës së pagave; verifikimin e ndryshimeve të mundshme; rishikimin e buxhetit për këtë kategori barazimet me Thesarin etj.

Ne kemi testuar mostra të pagave nga Departmenti i Administratës Qëndrore, Institucioneve vartëse si dhe Bibliotekës Kombëtare për të verifikuar nëse ekziston pajtueshmëri midis listës së pagave me sistemin e payrollit, procedurat e rekrutimit dhe rregullsinë e dosjeve të personelit.

Rekomandimet

Çështja 11 - Kontratat për shërbime të veqanta - Prioriteti i lartë

- E gjetura** Në Ministri dhe institucionet vartëse janë gjithsej 70 persona të angazhuar me kontrata për shërbime të veqanta. Përkundër vërejtjeve tona nga auditimet e kaluara, 8 prej tyre ishin angazhuar gjatë vitit 2014. Derisa 35 prej tyre paguhen nga buxheti për subvencione dhe transfere dhe kohëzgjatja e kontratave të tyre vazhdohet çdo 3 muaj. Vlera e paguar për këta të angazhuar gjatë vitit 2014 ishte 91,771€.
- Rreziku** Aplikimi i angazhimeve përmes kontratave për shërbime të veqanta në kundërshtim me rregullativën ligjore mund të rezultoj në pagesa të parregullta, dhe performancë të dobët operationale.
- Rekomandimi 11** Ministri duhet të inicojë një rishikim gjithpërfshirës të stafit të rregullt dhe të angazhuar me kontrata për të përcaktuar saktë nevojat për staf të Ministrisë dhe Institucioneve vartëse, dhe të gjitha pozitat e nevojshme të plotësohen me staf të rregullt, përmes procesit të hapur të rekrutimit.

Çështja 12 - Kompenzime jo të rregullta të punonjësve të Ministrisë - Prioriteti i lartë

- E gjetura** *Pagesa ndaj nëpunësit përkundër mungesës në punë* - Një zyrtar ishte pezulluar nga detyra e tij me dakordim nga Menaxhmenti për kryerjen e një funksioni tjetër publik. Nga muaji prill është kthyer në Ministri dhe është kompenzuar retroaktivisht për muajt paraprak me 916€ përkundër mungesës në punë;
- Kompenzimi i punës jashtë orarit* - Në 15 raste për kompenzimin e zyrtarëve të MKRS-së prej 1,727€ ka munguar kërkesa/aprovimi për punën e kryer. Në dy raste puna gjatë vikendit nuk është evidentuar fare. Në tri raste prej (406€), kërkesat dhe aprovimet janë bërë drejtpërdrejtë të ZKA;
- Kompenzimi i pagave më të larta se që ishin në kontratë* - pesë zyrtarëve të angazhuar me kontrata për shërbime të veqanta u ishin paguar nga 375€ përderisa në kontrata pagat mujore ishin 337€. Kjo ka shkaktuar mbipagesa në vlerë 531€; dhe
- Të gjeturat e shpalosura më lartë kanë ndodhur sepse ka munguar monitorimi i mirëfilltë i burimeve njerëzore dhe nuk ishin aplikuar rregulloret e jashtme me konisistencë.
- Rreziku** Pagesat për punëtorët përkundër mungesës në punë dhe jo në harmoni me kontratat rezultojnë me pagesa të tepërta/parregullta dhe zvogëlimin efektivitetit të Organizatës. Mungesa e kontrolleve adekuate tek kompensimet për punë shtesë mund të rezultojnë me pagesa të dyfishta dhe për punët që janë kryer në kuadër të orarit të punës apo nuk janë kryer fare.
- Rekomandimi 12** Ministri duhet të iniciojë një rishikim të hollësishëm të menaxhimit të pagave dhe kompensimeve për të gjetur shkaktarët e këtyre mbipagesave dhe të sigurojë përforcimin e kontrolleve në këtë fushë, për të mundësuar që listat e pagave azhurnohen rregullisht dhe të reflektojnë vijueshmërinë në punë. Punët jashtë orarit duhet të planifikohen dhe kompenzohen pasi të aprovohen fillimisht nga mbikqyrësi, pastaj nga ZKA.

Çështja 13 - Avancimi/transferi i stafit në kundërshtim me rregulloret - Prioritet i mesëm

E gjetura

Dy zyrtarë ishin avancuar duke mos e pëmbushur kohën minimale në gradën ekzistuese. Ndërsa në rastin tjetër gradimi ishte bërë në dy grada më të larta se sa që është e lejuar me kriteret ligjore;

Me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm dy zyrtarë janë transferuar në pozita me grada dhe kategori më të larta se ato aktuale, ndërsa dy të tjerë në pozita me gradë më të ulët se ato paraprake. Sipas rregullores ekzistuese për transferimin e nëpunësve civil, transferet e nëpunësve mund të realizohen për ushtrimin e funksioneve të njejta ose të ndryshme brenda Organizatës brenda kategorisë funksionale dhe gradës së njejtë; dhe

Ligji i Shërbyesve Civil përcakton që ushtruesit e detyrës nuk mund të emërohen më gjatë se tre muaj. Përgjatë vitit 2014, në Ministri ishin mbuluar dy raste të cilët e kishin tejkaluar afatin ligjor. Zyra e personelit nuk kishte inicuar procedurë të nevojshme për plotësimin e këtyre pozitave të lira.

Çështjet e identifikuar më lartë ka ndodhur sepse rregulloret ekzistuese nuk ishin aplikuar.

Rreziku

Mos aplikimi i rregullave për avancimin e stafit dhe ushtrimi i pozitave udhëheqëse nga ushtrues detyre mund të rezultoj me performancë të dobët operationale. Mospajtueshmëria me kërkesat ligjore mund të rezultoj në praktika të punës jo efektive.

Rekomandimi 13

Ministri duhet të sigurojë që procedurat e kërkuara të avancimit dhe të rekrutimit janë aplikuar konform rregullave dhe të rrit kontrollet e brendshme duke siguruar që rregulloret relevante janë respektuar me konsistencë në të gjitha rastet.

Çështja 14 - Mangësi në procedura të rekrutimit - Prioriteti i mesëm

- E gjetura** Për pozitën “Drejtor i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve” nuk ishin respektuar kriteret e kërkuara. Ishin kërkuar 4 vite përvojë punë në nivel drejtues, ndërsa ka munguar dokumentimi i përvojës nga i përzgjedhuri; dhe
- Për pozitën “Udhëheqës i Divizionit për hartim dhe harmonizim të legjislacionit” raporti i Komisionit vlerësues nuk përmbante informata për kandidatin e sukseshëm dhe kandidatët që e kanë kaluar procesin e vlerësimit. Poashtu, në bazë të vendimit, Komisioni vlerësues përbëhej nga pesë anëtarë, ndërsa të gjitha dokumentet e vlerësimit ishin nënshkruar nga 4 anëtar.
- Rreziku** Përzgjedhja e personave joadekuat duke mos i plotësuar kriteret e punësimit rrezikon që Ministria të angazhoj persona joadekuat në punë.
- Rekomandimi 14** Ministri duhet të siguroj që proceset e rekrutimit të sigurojnë se personat meritator po pranohen në punë duke reflektuar saktë objektivat e vëna të Organizatës.

4.4.4 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Subvencionet e MKRS ndahen për mbështetjen e projekteve të Departmentit të Sportit, Kulturës, Rinisë dhe Trashigimisë Kulturore. Poashtu, mjetet nga kjo kategori ndahen edhe për financimin e aktiviteteve të Institucioneve vartëse, Federatave të Sportit, etj. Në shkurt 2015 është miratuar rregullorja për menaxhimin e subvencioneve, mungesa e të cilës kishte shkaktuar mangësi në menaxhimin e mirëfilltë të projekteve të financuara.

Rekomandimet

Çështja 15 – Shpenzimi i mjeteve nga Subvencionet për natyrë tjetër të shpenzimeve – Prioritet i lartë

E gjetura *Për shtypje, printim dhe furnizim me material shpenzues*, Ministria dhe disa Institucione vartëse kishin paguar 62,609€ nga kategoria e subvencioneve. Për këto furnizime nuk kishte koordinim të Ministrisë dhe Institucioneve, pasi që disa Institucione ishin furnizuar edhe me artikuj që nuk ishin pjesë e kontratës;

Sigurimi i Objekteve - Ministria kishte nënshkruar çdo muaj kontratë për sigurim të objekteve të Ministrisë dhe Institucioneve vartëse pa zhvilluar procedura të prokurimit, duke shpenzuar 27,110€ për vitin 2014. Përveq kësaj këto shërbime janë paguar nga subvencionet dhe transferet. Nga kategoria e subvencioneve janë paguar edhe 36,805€ për anëtarët e pesë⁹ Këshillave Drejtues të Institucioneve Vartëse;

Pagesa të ndryshme - Ministria kishte paguar nga subvencionet për tatimin mbi pronë, krijim të web-faqeve, shpenzime shëndetësore, lektorime të materialeve dhe shtypje të katalogjeve, shumën prej 51,552€. Ndërsa 5,100€ janë paguar për punë jashtë orarit (gjatë vikendeve për 3 muaj) për punëtorët e Filharmonisë.

Rreziku Lidhja e kontratave pa procedura të prokurimit dhe pagesa nga subvencionet për shpenzimet që i takojnë kategorive tjera ka shkaktuar keqklasifikim material të shpenzimeve, dhe pagesa të parregullta.

Rekomandimi 15 Ministri duhet të sigurojë se kategoria e subvencioneve do të përdoret vetëm për qëllimet e saj. Klasifikimi i rregulltë i shpenzimeve do të jetë prioritet i Ministrisë për shkak të rëndësisë që ka klasifikimi i saktë për PVF dhe lexuesit e tyre. Poashtu Ministri duhet të sigurojë se procesi i prokurimit nuk do të jetë i fokusuar vetëm në arritjen e kërkesave ligjore, por të sigurojë proces efektiv të prokurimit. Prosesi i buxhetimit të saktë duhet të forcohet dhe bashkëpunimi në mes departamenteve respektive të zhvillohet në mënyrë që sigurohen aktivitetet e planifikuara nën kategorinë dhe kodin e saktë.

⁹ “Ansambli Shota”; Filharmonia e Kosovës”; Galeria Kombëtare e Kosovës”; “Qendra Kinematografike e Kosovës” dhe “Teatri Kombëtar i Kosovës”.

Çështja 16 - Projekte/Avanse të paarsyetuara nga përfituesit - Prioritet i lartë

E gjetura

Projektet e hapura dhe ato në proces të mbylljes - Sipas rregullës së Thesarit, OB duhet të bëjnë barazimet në mes të regjistrave të mbajtur për subvencionet, dhe raportet bankare të cilat harmonizohen me SIMFK. Përgjatë vitit 2014 nuk ka pasur politikë adekuate lidhur me monitorimin e mirëfilltë të projekteve që subvencionon Ministria. Nga viti 2008 deri 2014 figurojnë avanse/projekte të pambyllura në vlerë 6,087,815€, nga të cilat 422,313€ ishin avanse në proces të mbylljes dhe nuk ka ndonjë mekanizëm rregullues që do ti kushtëzonte përfituesit e fondeve, me mbyllje të avanseve paraprake.

Mos-arsyetimi i duhur i projekteve - Në nëntë raste mungonte arsyetimi i plotë financiar për projektin e financuar, ndërsa në nëntë raste tjera arsyetimi financiar nuk përkonte me projektin. Vlera e këtyre projekteve ishte 83,649€. Poashtu në tetë raste në vlerë 30,500€ avanset që figuronin si të mbyllura në regjistrin e MKRS-së, përfituesit nuk kishin raportuar fare për ecurinë financiare dhe operative; dhe

Pagesa jashtë Memorandum të Mirëkuptimit - Ministria kishte nënshkruar Memorandume të Mirëkuptimit për përkrahje financiare të federatave sportive, ku përcaktohen edhe vlerat monetare. Në një rast, kishte tejkallim të shumës së lejuar me memorandum për 6,000€.

Këto çështje ishin ngritur ngase mungonte një mekanizëm adekuat për implementimin e duhur të menaxhimit të subvencioneve.

Rreziku

Numri i madh i projekteve të paarsyetuara bën të pamundur konfirmimin nëse objektivat e Ministrisë janë arritur. Mosarsyetimi dhe mos raportimi për projektet e subvencionuara dhe tejkallimi i marrëveshjeve, shkaktojnë menaxhim të dobët buxhetor dhe mund të shkaktoj përdorimin e fondeve në kundërshtim me synimet e planifikuara. Vonesat e mëdha në mbylljen/arsyetimin e subvencioneve mund të rezultojnë në pasqyrim të gabuar të informatave në PVF.

Rekomandimi 16 Ministri duhet të siguroj që projektet e subvencionuara të jenë subjekt i monitorimit të rregullt nga zyrtarët e Ministrisë, për të siguruar respektimin e kërkesave/afateve për raportim të përfituesve për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve. Aty ku nuk respektohen kërkesat dhe afatet kohore për arsyetimin e shpenzimeve duhet të ndërmerren masat e nevojshme ndëshkuese.

Çështja 17 - Pagesat për të angazhuarit në shfaqjet e TKK-së - Prioriteti i mesëm

E gjetura

Angazhimi i aktorëve të jashtëm - Në kontratën e nënshkruar ndërmjet TKK-së regjisorëve për realizimin e tri¹⁰ shfaqjeve me vlerë 72,822€, aktorët duhet të angazhohen nga stafi i rregulltë i TKK (me përjashtime të veqanta). Ndërsa, në këto shfaqje pothuajse të gjithë aktorët janë angazhuar nga jashtë;

Pagesa e të angazhuarve në shfaqje bazohet në një Rregullore për pagesa artistike të nënshkruar nga ish Drejtori i TKK e cila nuk ka bazë ligjore. Përveq kësaj shumë pozita dhe role për të angazhuarit nuk janë të parapara në këtë rregullore;

Pagesa për të angazhuarit në shfaqje jashtë buxhetit të projektit - Për të angazhuarit në shfaqje është paguar vlera prej 3,990€ për punë dhe shërbime të kryera. Pagesa të tilla nuk janë të rregullta pasi që mjetet janë paguar nga buxheti i planifikuar i shfaqjeve tjera;

Pothuajse, asnjë nga shfaqjet nuk i ishin përmbajtur mbajtjes së reprizave dhe shfaqjeve sipas kontratës;

Aktorët rezident të TKK paguhen dyfish - Tre aktorë rezident të trupës së TKK janë paguar dy herë (përmes listës së pagave dhe nga buxhetet e shfaqjeve të financuara nga Ministria) vlera e mbipagesës ishte 5,040€; dhe

Pagesë për punë që nuk janë dokumentuar- TKK e kishte paguar vlerën prej 1,270€ me aprovim të Drejtorit të TKK-së për ndërtimin e platformave për marketing dhe marrëdhënie me publikun si dhe promovimin e stjuardesave për shfaqje. Nuk ekziston ndonjë raport që një punë e tillë është kryer dhe pagesa ishte bërë nga buxheti i një shfaqjeje. Një gjë e tillë është në kundërshtim me rregulloret ekzistuese të kontraktimit të punimeve.

Rreziku

Moszbatimi i kërkesave kontraktuale dhe mungesa e qartësisë në rregulloret e pagesave ka rezultuar në mbipagesa dhe pagesa të parregullta. Kjo mund të zvogëlojë efektivitetin e kontrolleve buxhetore dhe ndikon negativisht në projektet e ardhme të planifikuara të TKK. Pagesa për punë që nuk janë dokumentuar shkakton pagesa të parregullta.

Rekomandimi 17 Ministri duhet që të angazhojë një grup punues për përpilimin e një rregullore gjithëpërfshirëse për pagesën e aktorëve dhe stafit tjetër të angazhuar në shfaqje i cili në mënyrë të qartë do të përcaktojë kush mund të paguhet dhe bazën për secilën pagesë të bërë. Duhet të zbatohen kontrole të përfocuara për të siguruar që vetëm pagesat e dokumentuara dhe të mbështetura me informata të nevojshme dhe mjaftueshme të realizohen.

¹⁰ Këto shfaqje janë: "Vorbulla", "Vdekja e një Komisioneri" dhe "Shakespeare Globe".

Çështja 18 - Shpenzimi i mjeteve nga Muzeu Kombëtar (MKK) dhe Instituti Arkeologjik i Kosovës (IAK) - Prioriteti i lartë

E gjetura Në lidhje me shpenzimet e krijuara nga MKK dhe IAK kemi identifikuar dobësitë në vazhdim:

Drejtori i Muzeut kishte bërë tërheqje nga llogaria komerciale në vlerë prej 3,067€, ndërsa nuk kishte ndonjë dëshmi të dokumentuar se për çfarë janë shpenzuar ato mjete;

MKK dhe IAK kishin zhvilluar tri procedura të prokurimit në vlerë prej 3,190€ për mallra dhe shërbime, përderisa nuk kanë zyrtar të certifikuar të prokurimit;

Drejtorët e Institucioneve vartëse kishin nënshkruar kontrata për punë të ndryshme në mungesë të aplikimit të procedurave të prokurimit në vlerë prej 34,060€. Përderisa sipas rregullave të prokurimit kërkohet që nënshkrimi i kontratave të bëhet nga udhëheqësi i prokurimit, një gjë e tillë rrezikon transparencën e procedurave të prokurimit.

Rreziku Tërheqjet nga llogaria bankare të pa-arsyetuara me dokumente dhe arsyetime të duhura ndikon në pagesa të parregullta dhe mundësi për keqpërdorim. Kontratat që nuk janë nënshtruar procedurave formale tenderuese mund të shkaktojnë mospranimin e shërbimeve të pritura dhe arritjen e vlerës së dobët për para.

Rekomandimi 18 Ministri duhet të shqyrtoj rastet e lartëpërmendura për t'i hetuar shkaqet pse pagesat janë bërë pa dëshmi të mjaftueshme dhe jo në bazë të procedurave të pritshme të prokurimit. Kontrollat e duhura dhe mbikqyrja duhet të futen dhe të mbështeten me rregullore të nevojshme për të siguruar që prokurimi i duhur dhe procedurat e duhura të pagesave janë zbatuar në të ardhmën.

Çështja 19- Pagesa nga Departmenti joadekuat dhe në xhirollogari private - Prioritet i mesëm

E gjetura Në tri raste, Ministria ka kryer pagesa nga mjetet e dedikuara për departamente tjera pa ndonjë aprovim paraprak. Vlera e këtyre pagesave kap shumën prej 27,835€; dhe

Në 3 raste¹¹ për përkrahjen e projekteve të caktuara, në vlerë 6,200€, Ministria kishte transferuar mjetet financiare tek zyrtarët përkatës në xhirollogari private, të cilët pastaj kanë bërë mbylljen e projektit. Këto pagesa nuk përkojnë me rregullat për shpenzimin e parasë publike.

Rreziku Pagesa e subvencioneve nga departmenti jo-adekuat shkakton mungesën e mjeteve financiare të departmentit përkatës dhe rrezikon arritjen e objektivave të vëna. Përkrahja e projekteve përmes transferimit të mjeteve në llogaritë bankare private rrit mundësinë për keqpërdorim eventual dhe humbje financiare.

Rekomandimi 19 Ministri në bashkëpunim me Departmentet përkatëse dhe mbështetjen e zyrës së financave duhet të shqyrtojnë kërkesat e sakta buxhetore të cilat reflektojnë nevojat reale të Departmenteve. Përkrahja financiare e projekteve duhet të përcillet përmes procedurave përkatëse të autorizimit dhe monitorimit duke siguruar se objektivat e shpenzimeve të kësaj fushe janë arritur.

¹¹Projekti "Rehabilitimi dhe Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore" "Përpilimi i Strategjisë" dhe "Promovimi i Diversitetit Kulturor".

4.5 Pasuritë dhe detyrimet

4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Ministria nuk kishte bërë përparime në regjistrimin e pasurisë. Regjistri i pasurive të Ministrisë ende nuk paraqet pasuritë totale të saj, dhe si i tillë është jo i besueshëm. Kjo tregon se Ministria nuk ka arritur të vendos kontrolle të duhura menaxheriale sa i përket pasurive.

Gjendja e pasurisë kapitale në vitin e kaluar ishte 52,895€, ndërsa vlera e pasurisë në fund të vitit 2014 në PVF është rritur në 10,978,133€. Në këtë rritje të vlerës së pasurisë kishte ndikuar përfshirja e investimeve në vijim si pasuri në përdorim.

Çështja 20 – Ministria nuk kishte bërë inventarizimin e pasurisë me kohë – Prioritet i lartë

E gjetura Ministria nuk kishte bërë inventarizimin e pasurive në fund të vitit, siç kërkohet me udhëzimet për menaxhimin e pasurisë. Inventarizimi i pasurisë ishte bërë në fillim të vitit 2014, mirëpo ndërlydhja e shënimeve nga raporti i inventarizimit dhe zyrtarës së pasurisë nuk ishte bërë. Si të tilla shënimet e prezantuara në PVF lidhur me pasuritë janë materialisht të pasakta;

Sistemi i SIMFK dhe E-pasurisë nuk shfrytëzohet nga BKK për regjistrimin e pasurisë, siç kërkohet me rregullën 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo-financiare.

Rreziku Mungesa e kontrolleve në menaxhimin e pasurisë dhe mos regjistrimi i saj sipas rregullave mund të shpie në humbjen, keqpërdorimin dhe përdorimin e paautorizuar të tyre. Mos regjistrimi i të gjitha pasurive ndikon në cilësinë e shënimeve të shpalosura në PVF.

Rekomandimi 20 Ministri duhet të sigurojë që komisionet e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë përfundojnë punën e tyre dhe raportojnë me kohë. Zyrtari për menaxhim të pasurisë duhet të regjistrojë dhe mirëmbajë regjistrat e pasurisë sipas Rregullores 02/2013 për menaxhim të pasurisë jo-financiare.

Çështja 21 - Regjistrimi i Investimeve në vijim si pasuri në përdorim - Prioritet i lartë

- E gjetura** Ministria i kishte regjistruar si pasuri në përdorim investimet në vijim me vlerë prej 11,522,269€. Ky regjistrim kishte shkaktuar edhe zhvlerësimin e akumuluar në vlerë prej 589,437€ për projektet në vijim gjë që bie në kundërshtim me kërkesat ligjore, pasi që pasuria e cila ende nuk ka filluar të përdoret nuk mund të zhvlerësohet.
- Rreziku** Keqklasifikimi i evidencave të investimeve në vijim shkakton keqkuptim dhe mbivlerësim të pasurive totale. Kjo gjithashtu mund të rezultojë në mungesë të llogaridhënies për mirëmbajtje të këtyre pasurive.
- Rekomandimi 21** Ministri duhet të siguroj që të gjitha projektet kapitale të financuara nga Ministria të evidentohen si investime në vijim, të shoqëruar me një plan me detajet dhe datat e transferit, përfituesit, kostos, etj. Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave duhet të shqyrtohet mundësia e korrigjimit të këtyre shënimeve në SIMFK për të pasur pasqyrë më reale të pasurive. Të njëjtat duhet të shpalosen edhe në PVF konform standardeve të kontabilitetit dhe rregullave të menaxhimit të pasurive.

Çështja 22 - Shpenzimet e derivateve për automjetet zyrtare e private-Prioritet i mesëm

- E gjetura** Ministria nuk mirëmban regjistrat për vijueshmërinë e shfrytëzimit të veturave zyrtare; dhe
- Pa ndonjë vendim paraprak, janë paguar 54,321 litra apo mbi 67,000€ për derivatet për shfrytëzimin e veturave private të stafit të Ministrisë. Pagesat e tilla janë në kundërshtim me rregulloret e aplikueshme.
- Dobësitë e identifikuara më lartë janë sinjal që nuk janë të vendosura kontrollet e duhura menaxheriale në shfrytëzimin e automjeteve zyrtare.
- Rreziku** Aprovimi i mbulimit të shpenzimeve të derivateve të veturave private, dhe mos ndjekja e udhëzuesve përkatës kanë rezultuar me shpenzim të pa arsyeshëm dhe të parregulltë të buxhetit.
- Rekomandimi 22** Ministri duhet të kryej një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e dala nga rregullat për menaxhimin e veturave zyrtare nuk janë aplikuar, dhe të përcaktojë masat e nevojshme që kjo gjendje të mos përsëritet.

4.5.2 Trajtimi i borxheve

Përshkrim

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnizuesve në fund të vitit 2014 ishte në shumën 1,353,292€, krahasuar me vitin 2013 ku shuma e obligimeve ishte 132,913€, rritja këtë vit ishte dhjetëfish më e madhe. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të sfidës buxhetore të MKRS pasi që regjistri i obligimeve të papaguara në PVF nuk kishte inkorporuar obligimet e papaguara nga Biblioteka Kombëtare. Aranzhimet e ZKF duhet të jenë më pro aktive për të siguruar plotësinë e obligimeve duke siguruar raportim efektiv të obligimeve.

Rekomandimet

Çështja 23 – Menaxhim i joefektiv i obligimeve të papaguara – Prioriteti i lartë

E gjetura Shuma prej 911,055€ për faturat e papaguara për projektet kapitale nuk janë prezantuar në PVF 2013, ndërsa janë paguar në 2014. Kjo kishte ndikuar që obligimet e reja dhe ato ekzistuese të mos ekzekutohen në nivel të kënaqshëm;

Vlera prej 25,715€ të obligimeve të papaguara nga BKK nuk ishte prezantuar në PVF e Ministrisë të vitit 2014;

Shtatë fatura me vlerë 1,658€ nuk ishin paraqitur si obligime të papaguara në 2014, ndërsa ishin paguar në tremujorin e parë të vitit 2015; dhe

Katër fatura në vlerë prej 423€ janë fatura të vitit 2015, ndërsa janë paraqitur si obligime për vitin 2014.

Rreziku Mospërfshirja e të gjitha faturave në pasqyrën e obligimeve të papaguara ndikon që të mos pasqyrohet gjendja e saktë e obligimeve dhe rezulton në nëndeklarim të kërkesave buxhetore për vitin vijues. Menaxhimi i dobët me buxhetin ka krijuar obligime të shumta që duhen paguar në vitin 2015 dhe kjo rrezikon që planet e ardhshme të shpenzimeve të mos arrihen për shkak të nevojës për të paguar obligimet e viteve paraprake.

Rekomandimi 23 Ministri duhet të ndërmerr një rishikim të linjave të raportimit të obligimeve dhe një vlerësim të menjëhershëm të borxheve, për të përcaktuar masat adekuate për përmirësimin e gjendjës aktuale. Pagesat duhet të ekzekutohen sipas vjetërsisë së obligimeve në mënyrë që Ministria të mos jetë subjekt i padisë nga operatorët ekonomik.

4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Sistemi i Auditimit të Brendshëm është pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm dhe për shkak të rëndësisë së tij ne e prezantojmë këtu veçmas. Ne marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit (KA). Përveç kësaj, ne i shqyrtojmë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë, si rezultat i punës së kryer nga auditimi i brendshëm dhe komiteti i auditimit.

NjAB përbëhet nga një drejtor dhe një zyrtarë. NjAB ka një plan vjetor i cili është i bazuar në planin strategjik të auditimit 2014-2016. Gjashtë raporte ishin kryer për vitin 2014, duke mbuluar disa fusha kryesore të llogarisë.

Komiteti i Auditimit kishte mbajtur gjashtë takime me auditorin e brendshëm përgjatë vitit ku janë shqyrtuar të gjitha raportet e NjAB.

Rekomandimi

Çështja 24 – Sistemi i auditimit të brendshëm - Prioritet i lartë

E gjetura Fushëveprimi i aktivitetit të NjAB nuk kishte përfshirë vitin aktual, por kryesisht aktivitetet e vitit 2013. Ndërsa menaxhmenti nuk kishte përgatitur plane të veprimit për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga NjAB.

Nga shtatori 2014, kishte skaduar mandati i anëtarëve të Komitetit të KA, ndërkohë që Ministria nuk kishte ndërmarrë veprime për emërimin e anëtarëve të rinj; dhe

Ndikimi i KA nuk ishte i mjaftueshëm në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, pasi rekomandimet e dhëna nga ZAP nuk ishin trajtuar, duke siguruar adresimin e plotë të tyre.

Rreziku Fokusimi i aktivitetit të NjAB në aktivitetet e vitit paraprak, pamundëson identifikimin dhe parandalimin e gabimeve dhe zvogëlon sigurinë që i ofrohet menaxhmentit në lidhje me efektivitetin e kontrolleve kyçe financiare. Mos-adresimi i rekomandimeve të dhëna nga NjAB do të rezultojë me vazhdimin e dobësive në kontrollet e brendshme të Ministrisë. Mungesa e kontributit të mjaftueshëm të KA rrezikon funksionalitetin dhe rolin e tij përmirësues të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Rekomandimi 24 Ministri duhet të sigurojë që Sistemi i Auditimit të Brendshëm të funksionalizohet më shumë. Në të ardhmen është e nevojshme të monitorohet përmbushja e planit të NjAB në baza tremujore dhe të ndërmerren veprime proaktive në mënyrë që çështjet e ngritura nga auditimi i brendshëm të adresohen në kohën e duhur. Përveç kësaj, KA duhet të ri-aktivizohet duke i dhënë mbështetje menaxhmentit dhe NJAB në implementimin adekuat të rekomandimeve.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit - d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
Rreziqet Sinjifikante	Ministri t'i analizoj arsyet e transfereve në fund të vitit dhe të identifikoj veprimet që duhet të ndërmerren, në mënyrë qe praktika e njëjtë të mos përsëritet në te ardhmen. Përderisa procedurat për investime kapitale udhëhiqen nga Ministria, transferimi i mjeteve në llogaritë e institucioneve vartëse nuk është i nevojshëm.			Rekomandimi nuk është implementuar, pasi që edhe këtë vit kanë vazhduar transferet për projekte kapitale në llogaritë e Institucioneve vartëse për projekte të cilat ende nuk kanë filluar.
Pasqyrat Vjetore Financiare	Ministri duhet të sigurojë që plani i hartimit të PVF-ve 2014 formalisht përfshin rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti me fokus të veçantë në fushat që konsiderohen me rrezik të lartë të gabimit dhe fushat ku janë identifikuar gabime.			Rekomandimi nuk është implementuar, pasi që përgatitja e PVF për vitin fiskal 2014 kishte shumë gabime dhe lëshime.
Qeverisja e Mirë	Ministri duhet të implementoj një strukturë të përshtatshme e qeverisjes përmes së cilës do të zhvillohet një kornizë e raportimit që i përmbush nevojat e MKRS-së. Duhet të përcaktohen qartazi rolet/pergjegjësitë ndërmjet Ministrisë dhe institucioneve për të siguruar përgatitje, rishikim dhe monitorim efektiv të raporteve dhe për ti arritur afatet e kërkuara.			Rekomandimi nuk është adresuar pasi që çështjet e njejta ishin përsësiritur edhe këtë vit.

<p>Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit</p>	<p>Ministri duhet të siguroj që përgatitja e buxhetit paraprihet nga një proces rigoroz i vlerësimit që reflekton të gjitha informatat relevante, përfshirë realizimet e viteve të kaluara dhe ndryshimet e pritura në vitin e ardhshëm. Theks i veçantë duhet të vendoset në identifikimin e pengesave dhe mundësive për rritjen e ekzekutimit në investimet kapitale. Monitorimi efektiv i buxhetit të vitit duhet të aplikohet për t'i adresuar shmangiet kundrejt shpenzimeve të planifikuara.</p>			<p>Rekomandimi nuk është adresuar, madje këtë vit është bër edhe më i theksuar.</p>
<p>Të Hyrat</p>	<p>Ministri duhet të zbatojë një proces të përshtatshëm të menaxhimit të hyrave me role dhe përgjegjësi të qarta të vendosura në mes të stafit të financave të MKRS dhe Institucioneve që realizojnë të hyra për të siguruar identifikimin efektiv, rishikimin dhe monitorimin e të hyrave të realizuara si dhe barazimin bankar të hyrave të tilla.</p> <p>Ministri duhet të sigurojë që të gjitha marrëveshjet në Institucionet kulturore të sigurojnë rrjedhë të të ardhurave për Institucionin dhe të jenë të ngarkuara për pjesën e tyre të kostos së komunalive. Objektet duhet të jipen në shfrytëzim nëpërmjet procesit të hapur tenderues.</p>			<p>Pika e parë dhe e dytë e rekomandimit nuk është adresuar, pasi që edhe këtë vit ishte situata e njejtë në lidhje me raportimin e të hyrave. Poashtu edhe Teatri Kombëtar nuk e kishte implementuar rekomandimin në lidhje me qiranë e byfësë.</p>

<p>Shpenzimet përmes prokurimit - Dobësitë sistematike</p>	<p>Ministri duhet të kryejë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar plotësisht në të gjitha rastet dhe të ushtrojë më shumë kontrolle për të siguruar se dobësitë sistematike të identifikuara janë adresuar , të identifikoj pengesat ne implementimin efektiv të kontrolleve të brendshme në lidhje me prokurimin dhe të ndërmer veprime për heqjen e këtyre pengesave.</p>			<p>Rekomandimi nuk ishte adresuar.</p>
<p>Shpenzimet përmes prokurimit - Dobësitë jo-sistematike</p>	<p>Ministri duhet të shqyrtojë pse kontrollet specifike të prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë dhe të ushtrojë më shumë kontrolle për të siguruar që situata e tillë të mos përsëritet. Poashtu duhet të identifikoj pengesat në implementimin e kontrolleve të brendshme në lidhje me prokurimin dhe të ndërmerren veprime të përshtatshme për heqjen e këtyre pengesave.</p>		<p>Dobësitë jo-sistematike ishin adresuar pjesërisht, pasi që disa çështje ishin përsëritur edhe këtë vit.</p>	
<p>Pagat dhe Mëditjet</p>	<p>Ministri duhet të implementoj një rishikim për të gjitha kontratat për shërbime të veqanta, të siguroj që të gjitha pozitat janë rregulluar dhe poashtu të siguroj që proceset efektive të rekrutimit janë implementuar për të siguruar që konkurset e hapura publike të përdoren për të plotësuar vendet e lira në të ardhmen.</p> <p>Ministri duhet të siguroj që Departmenti i personelit ndërmer një rishikim gjithëpërfshirës të raportit në mes të koeficientëve të pagës dhe përshkrimit të punës për eliminimin e mospërputhjeve. Veprim i ngjajshëm duhet të ndërmerret për të siguruar implementimin e kontrolleve efektive që stafi të paguhet nga Departmenti i saktë dhe pagesat për Fondin për kuadro të jenë të aprovuara saktë.</p>			<p>Të gjitha pikat e rekomandimeve në lidhje me pagat dhe mëditje nuk ishin adresuar.</p>

<p>Subvencionet dhe Transferet</p>	<p>Ministri duhet të shqyrtoj rastet e lartpërmendura për t'i hetuar shkaqet pse pagesat janë bërë pa dëshmi të mjaftueshme dhe/ose jo në bazë të procedurave të pritshme. Kontrollat dhe mbikqyrja duhet të futen dhe të mbështeten me rregullore të nevojshme për të siguruar që prokurimi i duhur dhe procedurat e duhura të pagesave janë zbatuar në të ardhmën.</p> <p>Ministri duhet që të angazhoj një grup punues për përpilimin e një rregullore gjithëpërfshirëse për pagesën e aktorëve dhe stafit tjetër të angazhuar në shfaqje i cili në mënyrë të qartë do të përcaktojë kush mund të paguhet dhe bazën për secilën pagesë të bërë.</p> <p>Ministri duhet të inicoj një rishikim të detajuar për të përcaktuar qartë objektivat e pagesave të subvencioneve dhe të siguroj implementimin e kontrolleve adekuate në mënyrë që të ndalohet bërja e pagesave jo të rregullta. Kjo duhet të jetë subjekt i rishikimit të rregullt të menaxhmentit përfshirë edhe vlerësimin e auditimit të brendshëm.</p> <p>Ministri duhet të rishikoj pse kontrollet e pritura nuk janë implementuar në mbylljen e avanceve dhe të siguroj kontrolle të zgjeruara, për të siguruar që kërkesat kontraktuale janë plotësuar në të ardhmen.</p>			<p>Asnjë nga rekomandimet në fushën e subvencioneve dhe transfereve nuk ishin adresuar, madje ato ishin bërë edhe më të theksuara.</p>
---	--	--	--	--

Pasuritë	<p>Ministri duhet të siguroj që procesi aktual i identifikimit, vlerësimit dhe regjistrimit të pasurisë të vazhdoj në mënyrë që të arrihet që evidencat e pasurisë të jenë të sakta, dhe në PVF-të e vitit 2014 të shpaloset komplet vlera e tyre. Ky proces duhet ti ketë synimet e qarta dhe arritja e tyre të rishikohet nga Ministri në baza mujore.</p> <p>Ministri duhet të siguroj që të gjitha projektet kapitale të financuara nga Ministria të evidentohen si investime në vijim, të shoqëruar me një plan me datat e transferit, përfituesit, kostos, etj. Të njëjtat duhet të shpalosen edhe në PVF konform standardeve të kontabilitetit dhe rregullave të menaxhimit të pasurive.</p>		<p>Pika e parë e rekomandimit ishte adresuar pjesërisht, pasi që ZKA kishte formuar në vitin 2015 kishte formuar Komisionin për identifikimin e objekteve dhe hapësirave në pronësi të Ministrisë, puna e të cilëve do të auditohet në vitin 2015.</p>	
Trajtimi i Borxheve	<p>Ministri duhet të siguroj që procedurat efektive janë implementuar për identifikimin dhe regjistrimin e obligimeve të paregjistruara dhe të siguroj që pagesat e obligimeve janë plotësuar.</p>	<p>Rekomandimi është implementuar.</p>		
Auditimi i Brendshëm	<p>Ministri duhet të sigurojë se do të ndërmerr masat e duhura që të forcoj bashkëpunimin në mes NjAB, Menaxhmentit dhe KA për të siguruar që është zhvilluar/ implementuar një plan i auditimit gjithëpërfshirës bazuar në vlerësim të rreziqeve dhe që rekomandimet e duhura që dalin nga NjAB të gjejnë zbatim.</p>		<p>Rekomandimi është implementuar pjesërisht.</p>	